

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më 18/06/2025 Tiranë, në zyrat e shoqërisë “Rose Belle” sh.p.k, u lidh kjo Kontratë shitblerje kuotash (e cila në vijim do të emërtohet “Kontrata”)

SHITËSI: Zj. Zj. Fiona Ruli , bija e Alueta dhe Vahid, e datëlindjes 08/12/1990, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet kartes se identitetit me nr.**J06208033U**, në cilësinë e shitësit.

BLERËSI : Znj. Xhesika Lushaj, e bija e Xhemile dhe Qerim, e datëlindjes 18/01.1994, lindur në Bajram Curri, dhe banuese ne Tiranë shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet kartes se identitetit me Nr J45118049J, në cilësinë e blerësit.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 (Kodi civil, i ndryshuar), Ligji Nr. 9901 datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”si dhe Ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”

Kushte paraprake:

Shitësi është ortak i vetëm në shoqërinë “Rose Belle” sh.p.k, me NIPT: M51425039T, me seli në adresën: Rruga Nacionale Tiranë – Elbasan, Farkë, Lundër, Zona kadastrale 2529, vol 12, fq. 193, nr pasurie 863/4-N225, Qendra tregtare TEG, kati I pare, njesia B019+B019a dhe zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 100 % të vlerës së kapitalit të shoqërisë.

Në përputhje me;

- 1-Vendimin e Asamblesë së Ortakut të vetëm, datë 17/06/2025 të Shoqërisë “Rose Belle” sh.p.k;
- 2- Në kushtet e parashikuara në këtë kontratë.

Znj. Fiona Ruli, në cilësinë e Ortakut të shoqërisë si zotërues i 1(një) kuote si dhe në cilësinë e shitësit, dëshiron që një kuotë në vlerën 25% të kapitalit që zotëron në Shoqërinë “Rose Belle” sh.p.k t’ja shesë znj. Xhesika Lushaj.

Çmimi i kuotës që ortaku znj. Fiona Ruli zotëron në Shoqërinë “Rose Belle” sh.p.k, do të jetë i barabartë me vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë dhe ortaku pranon ta shesë në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë.



XhL

Nga ana tjetër znj. Xhesika Lushaj, pranon të blejë kuotën si më lart e cila në total përfaqëson 25 % të kapitalit të shoqërisë dhe që shitësi bie dakort ta shesi, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë.

Meqënëse ekzistojnë kushtet paraprake, palët bien dakort sa më poshtë:

Neni 1 **Kushtet paraprake dhe Shtojcat**

Kushtet paraprake konsiderohen pjesë integrale e kësaj Kontrate ("Kontrata").

Neni 2 **Objekti i kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është shit-blerja e kuotës të shoqërisë në masën 25% të kapitalit të shoqërisë "Rose Belle" sh.p.k nga Ortaku Fiona Ruli tek Ortaku Xhesika Lushaj.
Kjo kuota të do të kalojnë nga shitësit tek blerësi, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë.

Neni 3 **Shitja e kuotave**

Shitësi Fiona Ruli dëshiron që të shesë një kuotë të saj zotëruese në shoqërinë Rose Belle në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Neni 4 **Deklarimet e Palëve**

- 4.1 Pala shitëse, deklaron me përgjegjësi të plotë se kuota e saj është e lirë nga cdo detyrim, barrë apo pretendim nga ndonjë palë e tretë.
- 4.2 Pala shitëse deklaron me përgjegjësi të plotë se kuota zotëruese dhe të drejtat që rrjedhin prej saj nuk janë subjekt i asnjë procesi gjyqësor civil, penal, administrativ apo procesi arbitrazhi.
- 4.3 Palët deklarojnë se nga casti i kalimit të kuotës dhe rregjistrimit të këtij ndryshimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ortakët bashkarisht , do të përgjigjen ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës.
- 4.4 Palët deklarojnë se, pagesa për blerjen e kuotave është likuiduar jashtë kësaj zyre.
- 4.5 Ky ndryshim i Ortakërisë së shoqërisë "Rose Belle" sh.p.k, duhet ti bëhet e ditur palëve të treta të lidhura me shoqërinë.

Neni 5 **Ligji i zbatueshëm**

Të drejtat dhe detyrimet e palëve të kësaj kontrate, do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Kontrata është përpiluar në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale. Kontrata, pasi përpilohet, lexohet në prezencë të palëve, të cilët shprehen se kanë kuptuar dhe e pranojnë atë, pasi pasqyron vullnetin e tyre të lirë dhe më pas e nënshkruajnë atë vullnetarisht.



Xh.L

PALËT

Blerësi

Xhesika Lushaj

Xhesika Lushaj
[Signature]

Shitësi

Fiona Ruli

Fiona Ruli
[Signature]

The stamp is circular with a double border. Inside the inner circle, at the top, is the text "NUJË: M51425039T". In the center is a stylized logo consisting of a heart shape with a leaf-like element. Below the logo, the text "Rose Belle" is written in a cursive font. At the bottom of the inner circle, the text "TIRANË - ALBANIA" is written.